



KERKESAT,  
PETICIONET,  
INICIATIVAT QYTETARE



**KERKESA** – Dokument shkresor apo elektronik, në formë të shkruar, i drejtuar Këshillit Bashkiak për të: 1- marrë një shërbim, 2- të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë një veprim apo të marrë apo mos marrë një vendim.

Kërkesa mund t'i drejtohet Këshillit:

- Nga një person apo organizatë
- Bashkërisht nga disa persona apo organizata, grupe që përfaqësojnë komunitetet, dhe shoqëruar me nënshkrime - në formën e një peticioni

# PETICIONI



# PETICIONI- PERKUFIZIMI

Një kërkesë drejtuar Këshillit Bashkiak apo Komisionit të Përhershëm të Këshillit, për **ta nxitur të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë një veprim apo marrë vendim me interes kolektiv publik**, i bërë me shkrim dhe i shoqëruar me nënshkrime nga një grup qytetarësh ose banorësh, grup organizatash apo grupe interesi, dhe që i adresohen për çështje në kompetencë ligjore të Këshillit, apo për një çështje për të cilën Këshill ka mundësi të influencojë apo llobojë.

# QELLIMI I PETICIONIT

- Inkurajon qytetarët të luajnë rol udhëheqës në përcaktimin e përparësive në politikë-bërjes së Bashkisë, jo thjeshtë për të nxitur debat publik
- Nevojat, shqetësimet, idetë merren parasysh formalisht nga Këshilli
- Mobilizon qytetarët, grupet e interes për të mbështetur formalisht një çështje të caktuar

# OBJEKTIVAT E PETICIONEVE

- Forcimi i demokracisë vendore
- Angazhimi i qytetarëve në çështjet e politikave publike
- Promovimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen bashkiake
- Ngushtimi i distancës midis të përfaqësuarve dhe përfaqësuesve të tyre,
- Promovimi i transparencës në vendimmarrjen e Këshillit

# PETICIONEVE I DREJTOHEN

- Këshillit Bashkiak
- Kryesisë së Fshatit
- Këshillit Komunitar në Lagje



# ÇËSHITJE PËR TË CILAT MUND TI DREJTOHESH KËSHILLI ME PETICION

Qytetarët dhe organizatat mund t'i drejtohen Këshillit me peticion për:

- Çështje që lidhen me përgjegjësitë ligjore të Këshillit
- Çështje që prekin Bashkinë ose komunitetet e Bashkisë
- Çështje për të cilat Këshilli është në gjendje të ushtrojë njëfarë ndikimi për zgjidhjen e tyre

# PARASHTRUESIT E PETICIONIT

- Parashtrues i petitionit mund të jetë:
  - çdo person mbi **18 vjeç**
  - shoqatë jo-fitimprurëse, shoqatë biznesi, sindikatë ose organ profesional, me kusht që aktiviteti i organizatës të zhvillohet brenda territorit të Bashkisë.
- Parashtrues i petitionit mund të jetë drejtues i një strukture me bazë komunitare që ngrihen nga Këshillit
  - kryetari i fshatit,
  - ndërmjetësi komunitar,
  - drejtuesi i zonës së përmirësimit të biznesit, apo.
- Parashtrues i petitionit nuk mund të jenë anëtarët e Këshillit Bashkiak

# FORMA DHE PERMBAJTJA E PETICIONEVE

- Baza ligjore e petitionit
- Titulli i petitionit
- Kërkesa e petitionit
- Arsyet e paraqitjes së petitionit
- Kontaktet dhe nënshkrimin e parashtruesve
- Nënshkrimet e mbështetësve të petitionit.
- Një paragraf ku të citohet se të dhënat personale do të përdoren vetëm për qëllimet e petitionit,
- Numri i identifikimit të petitionit
- Citimi se peticioni është i hapur për publikun
- Afati (data dhe ora) i përfundimit të nënshkrimeve të petitionit.

# TRANSPARENCA E PETICIONEVE

Janë të hapur për publikun në faqen e internetit të Bashkisë:


- Format i petitionit
- Përmbajtja e petitionit
- Emrat e parashtruesve
- Emrat e nënshkruesve
- Afati (data dhe ora) e përfundimit të nënshkrimeve të petitionit.


## REFUZIMI I PRANIMIT TË PETICIONIT PËR SHQYRTIM NGA KËSHILLI

Këshilli mund të refuzojë pranimit të petitionit për:


- Çështje për të cilën Këshilli nuk ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë ose nuk ka ndikim.
- Çështje që lidhet me një vendim për planifikimin apo zhvillimin e territorit.
- Çështje që lidhet me një kërkesë për licence/ leje/ përfitim financiar apo aplikim tjetër.
- Çështje, rregullimi i të cilës është përcaktuar me ligj.
- Çështje për të cilën egziston një proces ligjor apelimi administrativ, një proces gjyqësor apo një procedurë ligjore e veçantë e ankimit.

# PROCESI I PETICIONIT





**Peticioni është paraqitur në formën dhe me të dhënat e kërkuara, si dhe me dokumentet bashkëngjitur**





# REFUZIMI I PETICIONIT

- Këshilli ka të drejtën të kërkojë verifikimin e emrit, adresës dhe nënshkrimit të çdo personi që mbështet petitionin
- Nëse peticioni, për nga objekti i tij, qartazi nuk bën pjesë në kompetencat e Këshillit, ky i fundit ia transmeton autoritetit përkatës, pasi ka ruajtur një kopje.
- Nëse peticioni nuk përcakton qartë se kush janë organizatorët, Këshilli nuk do të shqyrtojë petitionin.

# KUFIJTE E PETICIONIT

- Peticionet e zakonshme duhet të nënshkruhen nga **të paktën 20/50 persona** që jetojnë, punojnë ose studiojnë në Bashki.
- Peticionet me më pak se 20/ 50 nënshkrime të vlefshme bien jashtë procedurës së trajtimit të kësaj rregullore, por në çdo rast ato do t'i përcillen drejtorisë përkatëse, nga Sekretari i Këshillit.
- Peticionet që kanë **mbi 100/500** nënshkrime të vlefshme do të kenë të drejtë të shqyrtohen nga një Komision i Përhershëm i Këshillit, i cili ka objekt të veprimtarisë së tij çështjen që paraqet peticioni.
- Peticionet që kanë **mbi 1000** nënshkrime të vlefshme do të kenë të drejtë të shqyrtohen nga një Mbledhje të Këshillit.

# PETICIONET ELEKTRONIKE

- Peticionet elektronike zhvillohen dhe dorëzohen përmes faqes së internetit të Bashkisë, dhe respektojnë të njëjtat kërkesa dhe procedura si peticionet me letër.
- Parashtruesit e peticionit dorëzojnë me shkrim në zyrën e protokollit të Bashkisë kërkesën për krijimin e peticionit elektronik, sëbashku me të dhënat e peticionit.
- Për të nënshkruar peticionin elektronik mbështetësit fusin në aplikacion e peticionit të dhënat si emrin, adresën postare apo kodin postar dhe një adresë të vlefshme email-i.
- Nëshkruesi do të marrë një email në adresën e tij/saj me anë të së cilës do të konfirmohet nëse adresa e email-it është e vlefshme.
- Një peticion elektronik nuk mund të zhvillohen njëkohësisht me një peticionin me shkresë, ndërkohë që ata kanë të njëjtën kërkesë dhe të njëjtët organizatorë.

## PETICIONET PËR MEKANIZMAVE PJESËMARRËS

- Përfshirjen e një pikë në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit
- Mbajtjen e një konsultimi publik
- Mbajtjen e një seance dëgjimore publike
- Ndërmarrjen e një procesi pjesëmarrës
- Krijimin e një organi të ri pjesëmarrës (p.sh komitet/ bord)
- Mbajtjen e një mbledhje jashtë radhe të Këshillit Bashkiak, ku të marrin pjesë organizatorët e petitionit
- Mbajtjen e një mbledhje të kryesisë së fshatit apo të këshillit komunitar, ku të marrin pjesë organizatorët e petitionit

## PETICION PËR NJË ÇËSHTJE QË ËSHTË NË PROCES KËSHILLIMI PUBLIK

- Shqyrtimi i petitionit pezullohet nëse çështja është në proces këshillimi publik nga Këshilli,
- Nëse peticioni përfshihen në procesin e këshillimit publik, organizatorët e petitionit do të informohen nga Sekretari për këtë vendim të Këshillit.
- Përveç përfshirjes në procesin e këshillimit publik, të gjitha peticionet që kanë lidhje me buxhetin e Bashkisë do të vihen në dispozicion për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit ku shqyrtohet buxheti.
- Kur peticioni dorëzohet pasi ka kaluar afati i këshillimit publik, por para se të merret vendimi nga Këshilli, dhe nëse çështje po diskutohet në njërin nga Komisionet e Përhershëm, person kontakti për petitionin do të ftohet në mbledhjen e Komisionit
- Nëse çështja është shqyrtuar tashmë nga një Komision i Përhershëm, peticioni do të merret në shqyrtimi në momentin kur Këshilli do të marrë vendim për çështjen.

## SHQYRTIMI I PETICIONIT NGA KËSHILLI

- Peticionet shqyrtohen nga Këshilli jo më vonë se **60 ditë** nga data e regjistrimit të petitionit në Bashki.
- Në një mbledhje të Këshillit apo të komisionit nuk mund të shqyrtohen më shumë se **3 peticione**
- Këshilli mund të vendosë që një petition të shqyrtohet me debat apo pa debat.
- Një petition mund të paraqitet nga një Këshilltar, në emër të parashtruesve të pranishëm në mbledhje.

## VEPRIMET E KËSHILLIT ME PETICIONET

1. Vendos për të miratimin e kërkesën e peticionit, me ose pa ndryshim.
2. Vendos refuzimin e kërkesës së peticionit.
3. Vendos për mbajtjen e një takim me parashtruesit e peticionit për të kuptuar arsyet se pse është dërguar peticioni.
4. Vendos për mbajtjen e një dëgjese publike në lidhje me çështjen e peticionit.
5. Vendos për ndërmarrjen e një hulumtimi rreth çështjes së peticionit, nga një komision i përhershëm i këshillit, komiteti i këshillit apo nga ekzekutivi

## ANKESA NDAJ VENDIMIT TË KËSHILLIT

- Parashtruesit mund t'i dërgojnë Këshillit ankesë me shkrim nëse nuk janë të kënaqur me përgjigjen dhe veprimin e komisionit apo vendimin e Këshilli,.
- Kryesia e Këshillit shqyrton **respektimin e procedurës** së shqyrtimit të petitionit, dhe Kryetari i Këshillit i kthen përgjigje jo më vonë se **15 ditë** nga data e regjistrimit në Bashki të ankesës.
- Nëse ankesa vlerësohet e drejtë, Kryesia vendos rishqyrtin e peticioni në Mbledhjen e Këshillit më të parë të radhës.
- Parashtruesit mund t'i drejtohen gjykatës administrative nëse janë të pakënaqur me vendimin e Këshillit për petitionin.